



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 39 Datë 23.02.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “WIND
POWER ALBANIA” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”; neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1, gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “*Rregullores për Procedurat dhe Afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “*Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.02.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k për licencim në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Wind Power Albania” sh.p.k., me shkresën nr. 164 Prot., datë 07.02.2018, ka aplikuar në ERE për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b” “c”) është plotësuar në mënyre korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Wind Power Albania” sh.p.k në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 –vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI